

Esad Islami, MA<sup>1</sup>

UDC:  
338.48-6:7/8(497.115)

**MUNDËSI PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT KULTUROR DHE  
NATYROR NË KOSOVË DHE TË ETIKËS SË MJEDISIT JETËSOR**

**МОЖНОСТИ ЗА РАЗВИВАЊЕ НА КУЛТУРНИОТ И  
ПРИРОДЕН ТУРИЗАМ ВО КОСОВО И ЕТИКАТА НА  
ЖИВОТНАТА СРЕДИНА**

**OPPORTUNITIES FOR DEVELOPING CULTURAL AND  
NATURAL TOURISM IN KOSOVO AND ENVIRONMENTAL  
ETHICS**

**Abstract**

Cultural heritage defines the identity of a human community and constitutes a valuable resource which, by its complex nature, is not renewable and therefore needs to be preserved and valued to guarantee permanence.

Cultural tourism aims to give its contribution by focusing on economic and employment aspects, emphasizing the values of cultural activities and its contribution to the conjunction and welfare of social relations, regional identity and community development in the urban context. Tourism, in short, involves the natural resources of a given country or region.

Many world countries consider tourism as a crucial factor for their economic development. However, in addition to natural resources,

---

<sup>1</sup> Esad Islami, PHD Candidat, University of Bitola, Faculty of tourism and hospitality, (esadislami@gmail.com)

human resources have been anticipated by experts, as the most critical factor that this industry has faced over the last decade. It is not enough for a country to be rich with natural attractiveness to be a tourist destination; it also needs proper management, culture, tradition, hospitality, quality of services, and so on.

All of these affect the evolution or development of natural resources that directly affect the economic growth of a country. The historical past and unique cultural heritage of the Balkans in general and of Kosovo as its part, is rich enough and eye-catching to attract many tourists and thus to play a significant role in their economic development.

**Keywords: Tourism, Kosovo, management, quality, resources, cultural**

### **Hyrje**

Turizmi përfshin aktivitetet e personave që udhëtojnë dhe qëndrojnë në vende të ndryshme nga vendi i qëndrimit të tyre të zakonshëm për një periudhë jo më të gjatë se një vit kalendarik dhe qëllimi i këtij udhëtimit është kohë e lirë. Turizmi, sot është një ndër industritë me të fuqishme në botë dhe si e tillë ajo ka një impakt të madh në zhvillimin ekonomik e social të shumë vendeve e sidomos atyre në zhvillim, ku shihet si një nga burimet më të rëndësishme të punësimit të diverzifikimit të ekonomisë, të mbrojtjes së ambientit si dhe të promovimit të shkëmbimeve kulturore.<sup>2</sup> Trashëgimia është vlerë e përcjellë brez pas brezi. Ajo përbën vlerë të mjedisit natyror dhe, si e tillë, është natyrore, por edhe vlerë materiale e shpirtërore shumë e çmuar ku ndër më të njohurat mund të veçohen: Kalaja e Prizrenit, Lidhja e Prizrenit, Gryka e Lumëbardhit, Qendra turistike në Brezovicë, Suka e Dermanit, Bifurkacioni i Nerodimes, Shpella e Panorcit, Shpella e Petreshticës, Gryka e Kaçanikut, etj. Rajoni Turistik i Anamoravës në këto komuna me lokalitetet e veta kanë atraksione turistike që në të ardhmen mund të shfrytëzohen për zhvillimin e turizmit. Ndër më të theksuarat janë: burimet e ujërave termale Banja në Kllokët, në Kmetoc, Uglar, monumete të trashëgimisë kulturore si Kalaja e Artanës, Kalaja e Pogradjës Manastiri i Decanit, Graçanicës, Kisha në Letnicë, Stubëll etj.

---

<sup>2</sup> [http://www.kohajone.com/html/artikull\\_56926.html](http://www.kohajone.com/html/artikull_56926.html)

Në përbërje të këtij thesari dhe kësaj trashëgimie kulturore e natyrore ka; objekte historike dhe të kultit, peizazhe, ekosisteme, habitate më të veçanta, të rralla apo unikale. Si të tilla, ato kanë rëndësi të madhe shkencore, kulturore, didaktike, edhe turistike. Këto vlera duhen promovuar në vazhdimësi dhe shfrytëzuar si mundësi e mire për zhvillim të turizmit.

## **PASURITË NATYRORE DHE TRASHËGIMIA KULTURORE E KOSOVËS**

Shekulli që po e lëmë pas do të mbahet mend për ndryshime të konsiderueshme të ndikimit të njeriut në mjedis, ndikim ky i lidhur përveç tjerash nga ritmi i lartë i rritjes së popullsisë në shkallë botërore dhe revolucionit tekniko-shkencor. Ky i fundit krahas rolit të madh që luajti në zhvillimin e industrisë dhe të ekonomisë botërore, pati edhe ndikime negative në natyrë dhe mjedis. Edhe Kosova e cila ndodhet në qendër të Gadishullit Ballkanik nuk ka qenë jashtë këtyre ndikimeve. Territori i saj me përbërje natyrore shumë komplekse me zona kodrinore, kodrinore-malore e fushore, të përshkuar nga lumenj është shumë tërheqës për studiues dhe vizitorë. Me bukuritë e rralla, vlerat burimore dhe estetike natyrore si dhe diversitetin biologjik të llojeve bimore dhe shtazore, territori i Kosovës është nga më të veçantit në Gadishullin Ballkanik dhe më gjerë. Në publikimin “Vlerat e trashëgimisë natyrore të Kosovës” janë prezantuar të dhënat themelore për vlerat më reprezentative natyrore të Kosovës, të mbrojtura dhe të propozuara për mbrojtje.

Vlerat e mbrojtura të natyrës përfshijnë sipërfaqe prej 46.247.3 ha ose 4.27 % të territorit të Kosovës. Prej tyre një Park Kombëtar, 11 Rezervate të Natyrës, 37 Monumente të Natyrës dhe 2 Peizazhe të Mbrojtura. Nga vlerat më përfaqësuese të natyrës së Kosovës përmendim: Parku Kombëtar Malet e Sharrit, Shpella e Mermertë në Gadime, Kanioni i Mirushës, Parku i Gërmisë, Bifurkacioni i Lumit Nerodime, Gryka e Rugovës etj. Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës si institucion qendror për ruajtjen e natyrës, monitoron gjendjen e vlerave të mbrojtura dhe njëkohësisht evidenton vlera të reja natyrore me rëndësi të veçantë. Deri më tani janë evidentuar rreth 200 sosh, në mesin e të cilave një Park Kombëtar, disa peizazhe të natyrës dhe shumë monumente natyre me karakter botanik, hidrologjik. Me shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna për Park të dytë Kombëtar dhe me marrjen nën

mbrojtje të zonave të propozuara, sipërfaqja e përgjithshme e zonave të mbrojtura do të rritej ndjeshëm (rreth 10 % e territorit të Kosovës). Ruajtja dhe menaxhimi, rritja e numrit dhe sipërfaqes së zonave të mbrojtura si dhe aplikimi i koncepteve mbi shfrytëzimin e qëndrueshëm të natyrës në harmoni me trendët ndërkombëtare, janë synime të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.<sup>1</sup>Pozita Gjeografike - Kosova gjendet në mes të Evropës Juglindore. Duke zënë pozitë qendrore në Gadishullin Ballkanik, paraqet nyje të rëndësishme të lidhjes midis, Evropës së Mesme dhe asaj Jugore, Detit Adriatik dhe Detit të Zi. Sipërfaqja e territorit të Kosovës është 10 908 km<sup>2</sup> dhe është e populluar me mbi 2 milionë banorë.<sup>3</sup>

**Klima:** Klima dhe temperaturat në Kosovë janë të ndryshueshme gjatë katër stinëve të vitit. Dimri është me borë dhe me temperatura të ulëta ku mesatarja arrin - 2°C. Pranvera dhe vjeshta janë të freskëta dhe me reshje, kurse vera është e nxehtë dhe e thatë - me temperatura mesatare + 22°C. Temperaturat e larta në Kosovë gjatë vitit janë mes + 25°C dhe + 38°C. Si të vijmë në Kosovë.

Disa nga vendet turistike në Kosovë

**Komplekset Malore:** Malet e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna ku dallohen Brezovica e Rugova si qendra skijimi dhe rekreacioni, Maja e Lubotenit, Maja e Gjeravicës e cila njihet si maja më e lartë në Kosovë që arrin lartësinë 2.656 metra etj.

**Qytetet muze:** Prizreni, Gjakova, Rahoveci, Dragashi, Juniku etj, kanë objekte të ndryshme me arkitekturë të rrallë nga epoka të ndryshme kohore, kultura nga civilizime të ndryshme.

Vendet Historike: Prekazi, Jezerci, Drenica, Kosharja, Glllogjani, Krusha.

Bukuritë natyrore: Bifurkacioni i Neredimes, Ujëvara e Mirushës, Burimi i Drinit, Shpella e Gadimës, etj.

**Burime Termale:** Banja e Klllokotit, Banja e Pejës.

Hotele, restorante, pishina, motele pranë rrugëve magjistrale.

<sup>3</sup> Krasniqi Mr. Armand, "E drejta në turizëm dhe hotelieri", Pejë 2004, f. 23

## POTENCIALET E TURIZMIT NË KOSOVË

Turizmi i bazuar në natyrë mund të ofrojë mundësi të mëdha për zhvillim dhe është sektori i dytë më i rëndësishëm pas bujqësisë me ndikim në zhvillim. Shpesh turizmi konsiderohet si një alternativë e suksesshme karshi bujqësisë intensive, pylltarisë ose peshkatarisë.

Eko turizmi paraqet një shembull ku të hyrat e pronarëve privat varen shumë nga shëndeti i ekosistemeve rrethuese. Ndonjë herë bizneset nuk i kushtojnë rëndësi ruajtjes së biodiversitetit, por ka shembuj kur ruajtja e biodiversitetit është ndërlidhur me rritjen e fitimit nga aktivitetet e turizmit. Turizmi në Kosovë radhitet ndër degët e ekonomisë me zhvillim të hovshëm në dhjetëvjeçarin e fundit. Në analizat strukturore dhe projeksionet afatgjata, turizmi vlerësohet si një shfaqje tejet dinamike me rëndësi për zhvillim dhe promovimin e zonave të mbrojtura të natyrës veçanërisht parqeve kombëtare dhe vlerave të trashëgimisë natyrore. Mundësitë që ka Kosova për një produkt të qëndrueshëm dhe konkurrent turistik, problemet dhe vështirësitë që e shoqërojnë zhvillimin e turizmit, do të trajtohen në këtë punim. Zhvillimi i turizmit dhe kapaciteteve turistike, grumbullimi i një numri të madh të njerëzve në zonat e mbrojtura të natyrës shpesh i kërcënon ekosistemet e ndjeshme dhe vendbanimet e vlefshme natyrore e me këtë bimët dhe shtazët. Për këtë arsye duhet të bëhet një analizë detale lidhur me ndikimet e turizmit në këto zona si dhe në llojet konkrete të bimëve dhe shtazëve. Rritja e numrit të vizitorëve do të ketë ndikim të dëmshëm në biodiversitetin e këtyre zonave.<sup>4</sup>

Zhvillimi i turizmit do të rezultojë edhe me shtimin e numrit të vizitorëve në zonat e mbrojtura të natyrës si dhe monumentet natyrore por vendi ynë nuk i ka të zhvilluara kapacitetet dhe ofertën turistike dhe edukative për vizitorët (fletëpalosjet, hartat, shoqëruesit turistik). Kosova vështuar në aspektin turistik është e ndarë në pesë rajone turistike: Rajoni qendror i Prishtinës; Rajoni turistik i Alpeve Shqiptare; Rajoni turistik i Sharrit; Rajoni turistik i Anamoravës; Rajoni turistik i Mitrovicës Bazuar në studimet e deritanishme në Republikën e Kosovës, ekzistojnë kushte shumë të mira për ngritje të qendrave turistike për turizmin dimëror-sportiv.

Rajoni turistik i Alpeve Shqiptare dhe rajoni i Sharrit janë dy rajone që kanë mundësit më të mira për zhvillimin e këtij lloji turizmit.

<sup>4</sup>[http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia\\_dhe\\_Plani\\_i\\_Veprimit\\_per\\_Biodiversitet.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit_per_Biodiversitet.pdf)

Ne vijim janë të pasqyruara mundësitë e ngritjes së qendrave për zhvillimin e turizmit dimëror-sportiv për këto dy rajone turistike. Qendrat turistike në rajonin turistik të Alpeve Shqiptare mund të ngritën me kapacitet të tërësishëm 129.000 vizitorë në vit ndërsa rajoni turistik i Sharrit 113.000 vizitorë në vit duke pas parasysh se këto dy rajone janë njëkohësisht edhe qendrat më të mëdha floristike dhe faunistike në Kosovë ndikimi i zhvillimit të turizmit në këto dy zona do të jetë negativ në ruajtjen e biodiversitetit. Kurse ana pozitive e krejt kësaj është se do të krijohen të hyra të cilat mund të orientohen në veprimtarit e mbrojtjes së natyrës si dhe për ndërtim të infrastrukturës, monitorim dhe hulumtime shkencore. Në aspektin e trashëgimisë natyrore, rajonet kufitare të Kosovës përbëjnë burimet kryesore që ofrojnë produkt unik natyror turistik, sikurse është rasti me rajonin jug-perëndimor të ‘Alpeve Shqiptare’ në kufi me Shqipërinë dhe Malin e Zi, rajonin jug-lindor të maleve të ‘Sharrit’ në kufi me Shqipërinë dhe Maqedoninë dhe rajonin verior të maleve të ‘Kopaonikut’ në kufi me Serbinë. Trashëgimia kulturore në Kosovë gjithashtu është shumë e larmishme. Kalatë e vogla sikurse kullat shqiptare, mullinjtë dhe urat, xhamitë dhe kishat, banjat turke, kështjellat dhe vendbanimet arkeologjike, që të gjitha ofrojnë një histori të pasur të rajonit. Duke pasur parasysh pasuritë natyrore dhe kulturore të Kosovës, segmentet sikurse figurojnë me poshtë aktualisht përfaqësojnë shtyllat kryesore të ofertës turistike:

**Turizmi kulturor:** Me objekte mesjetare të përfshira në listën e trashëgimisë kulturore të UNESCO-s, me gjithsejtë 41 vende arkeologjike të rëndësisë së lartë, me një jetë nate të shoqëruar, me skenë të larmishme muzikore, me një mikpritje të jashtëzakonshme të vendasve. Kosova ka shumë për të ofruar në relacion me turizmin kulturor.<sup>5</sup>

**Turizmi malor dhe alpin:** Me vendpushime dimërore dhe për skiator sikurse Brezovica në Malet e Sharrit. Kosova ka mundësinë që të forcojë dhe të përmirësojë pozitën e saj si destinacion për pushime dimërore. Me respekt të ofrimit të shërbimeve dhe produkteve turistike përgjatë gjithë katër stinëve të vitit, lugina e Rugovës tashmë vetëm se ka zhvilluar një numër të konsiderueshëm të ofertave turistike me operatorët turistikë.

Turizmi rural, eko-turizmi dhe turizmi alternativ: Akomodimi ‘shtrat dhe mëngjes’ (“Bed and Breakfast”) vetëm se është pjesë e ofertës turistike në ‘Velika Hoç’ (Novobërdë) dhe disa nga vendet tjera rurale të Kosovës.

<sup>5</sup><http://www.mti-ks.org/sq/Divizioni-i-Turizmit>

**ZHVILLIMI I TURIZMIT NË KOSOVË**

Kosova ka shanse të mrekullueshme për zhvillim të turizmit. Disponon me atraksionet natyrore të begatshme, me lokacione gjeografike të volitshme. Disa prej përparësive të saj turistike të veçanta janë veçoritë e dallueshme morfologjike, hidro-grafike, klimatike dhe elemente të tjera atraktive të cilat e bëjnë Kosovën një ndër hapësirat turistike më tërheqëse në rajon. Edhe pse Kosova nuk posedon disa faktorë, të cilët kanë ndikim tërheqës, në pjesën më të madhe të kërkesës turistike, siç është deti, ajo disponon me potencial të jashtëzakonshëm natyror dhe mundësi tjera për zhvillimin e gati të gjitha formave të turizmit, në radhë të parë, të turizmit dimëror-sportiv, malor, shëndetësor, transit, gjuetisë, turizmit të biznesit etj. Studimet e bëra kanë treguar se në Kosovë ekzistojnë mundësi për ndërtimin e 20 qendrave të turizmit dimëror, të cilat mund të ofrojnë kushte shumë të mira për zhvillimin e turizmit dimëror-sportiv, sipas standardeve ndërkombëtare. Grykat, kanjonet dhe shpellat si motive turistike janë atraksione turistike që paraqesin forma të ngushta relievore të maleve që kanë anë vertikale. Estetika dhe kurioziteti që disponojnë grykat i bëjnë këto atraktive për turizëm. Edhe qafat malore hyjnë në kategorinë e grykave.

Ekziston numër i konsiderueshëm i grykave, shpellave dhe kanjoneve. Alpet shqiptare dhe masivi i Sharit janë rajonet më të pasura me gryka, shpella dhe kanjone. Grykat më të njohura në Kosovë janë: Gryka e Rugovës, e Kaçanikut, Carralevës, Ibrit etj. Gryka e Rugovës me bukuritë e veta natyrore është gryka më e njohur në rajon dhe më gjerë.<sup>6</sup> Në Kosovë kanjoni më i njohur është kanjoni i Mirushës, i cili ka sistem prej 13 ujëvarave dhe liqeneve të mëdhenj dhe të vegjël me një bukuri madhështore. Shpellat paraqesin forma gjeomorfologjike për relievin, në turizëm kanë rol të veçantë për arsye se vizitat që iu bëhen kanë karakter turisti. Përveç shpellës së Gadimes ka edhe shpella tjera, të cilat ende nuk janë të përgatitura për t'u vizituar nga turistët si: shpella e Radavcit, e Panorcit, Petreshticës, Bresalcit, në Grykë të Rugovës etj. Elementet hidrografike, janë element mjaft i rëndësishëm i trashëgimisë natyrore të një vendi. Përmes ujërave sipërfaqësore dhe

---

<sup>6</sup> Konferenca "Perspektiva e Turizmit Fshatar në Regjionin e Rugovës", 07.Prill.2007, Pejë, f. 1-4

nëntokësore mund të tregohet kompleksi natyror i përbërjes gjeologjike, relievit, klimës, florës dhe faunës si dhe aktivitetit të njeriut për përshtatjen dhe shfrytëzimin e elementeve hidrografike për plotësimin e nevojave të ndryshme. Pozitën gjeografike që ka Kosova, me lartësi mesatare (811m), mbyllja e hapësirës së saj me male të mesme dhe të larta në pjesët periferike krijuan kushte për formimin e nyjës hidrografike në Kosovë. Ujërat e Kosovës në Sukën e Dermanit në malin e Nerodimës ndahen dhe derdhen në tri pellgje: në detin Adriatik, Egje dhe në Detin e Zi. Lumenjtë, atraktiviteti natyror që kanë lumenjtë në luginat e veta shërbejnë edhe për zhvillimin e turizmit. Rëndësia turistike e lumenjve, përveç përqendrimit në shfrytëzimin e tyre për larje, zhvillimin e sporteve, si noti, peshkimi etj, ata me kanjonet, grykat dhe ujëvarat që kanë, paraqesin attribute atraktive për zhvillim të turizmit. Lumenjtë e Kosovës janë të njohur me atraktivitetin dhe estetikën e tyre natyrore, që mund të përdoren për zhvillimin e turizmit.

Lumenjtë, siç janë: Mirusha, Burimi i Drinit të Bardhë, Nerodimja etj. me atraktivitetin e tyre natyror mahnitës, janë atraksione mjaft interesante për turistët. Liqene, ka po thuaj në të gjitha gjiret gjeografike dhe në lartësi të ndryshme mbidetare, të cilët kanë rëndësi për zhvillimin e turizmit, sidomos në vendet kontinentale, të cilat nuk kanë det. Për nga lloj i liqeneve dallohen liqenet akullnajor, lumor dhe relikte (artificial). Liqet e akullnajave janë më të bukurit prej të gjitha llojeve për arsye se ata gjenden në zonat malore dhe janë pjesë e pandashme e atraksioneve.

Kosova është e pasur me këto tri lloje të liqeneve. Liqene akullnajore në Kosovë ka më së shumti në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit.

Në Alpet shqiptare janë të njohura këto liqene: Në Malet e Gjeravicës janë liqeni i madh, liqeni i vogël, në Rugovë liqeni i Leqinatit; në Malet e Sharrit janë 16 liqene, prej tyre janë: Liqeni i Livadhit; Liqeni i Bogovinës; Liqeni i Zi; Liqeni i Jazhicës; Liqeni i Sipërm etj. Ujërat termale, Kosova ka burime të rëndësishme të ujërave termale, të cilat shfrytëzohen për qëllime mjekësore dhe rekreative. Këto resurse nuk shfrytëzohen racionalisht e as nuk janë hulumtuar sa duhet. Zyrarisht ekzistojnë vetëm tri qendra shëruese: Banja e Pejës, e Kllokotit dhe Banjëska (në veri të Mitrovicës). Megjithatë, ekzistojnë edhe burime tjera, të cilat nuk shfrytëzohen dhe nuk janë hulumtuar, më të njohura janë: burimi i ujit në Malishevë, Uglar, Poklek, Dobërzan, Luzhan, Deçan etj.



### Motivet antropogjene

Oferta turistike e një vendi turistik është e përbërë nga motivet natyrore dhe motivet antropogjene. Motivët antropogjene janë faktorë atraktivë shoqëror, të cilët nxisin qarkullimin turistik. Numër i konsiderueshëm i turistëve, për të kënaqur kërshërinë e tyre turistike, vizitojnë vende të ndryshme historike, objekte të njohura kulturore. Motivët antropogjene janë objekt i qarkullimeve turistike, numër i madh i turistëve kërkojnë vende historike, objekte kulturore të njohura, fushëbeteja, ngjarje të rëndësishme historike etj, me qëllim të zgjerimit të njohurive të tyre dhe njohjes më përsëfermi të këtyre vlerave. Vështruar për nga lloj, motivët antropogjene janë të llojllojshme, të cilat së bashku janë segment i rëndësishëm i ofertës turistike të një vendi. Bazuar në efektet dhe funksionet turistike që kanë mund të ndahen:

- ❖ Monumente kulturore-historike;
- ❖ Institucione kulturore;
- ❖ Manifestime kulturore;
- ❖ Manifestime argëtuese dhe sportive;
- ❖ Produktet e artizanateve si motive etnosociale.

Numri i madh i resurseve turistike më atraktive, nuk janë as përafërsisht të valorizuar në masë cila do të mundësonte plasman të suksesshëm në tregun turistik të vendit dhe të huaj. Shkaqet për këtë pozitë të turizmit rural janë të shumtë, por ndër më të rëndësishme janë:

- ❖ mungesa e përvojës, e vetëdijes për leverdinë ekonomike të një aktiviteti të tillë,
- ❖ mungesa e kulturës së përgjithshme të ekonomive familjare fshatare,<sup>7</sup>
- ❖ mungesa e masave të politikës ekonomike në nivel të vendit për stimulimin e zhvillimit të turizmit rural; mungesa e bashkëpunimit me akterët tjerë të ofertës turistike të Kosovës etj.

Zhvillimi i turizmit rural mundëson: përmirësimin e kualitetit të jetës dhe statusit material të banorëve në rajonet fshatare dhe ekuilibrimin e zhvillimit rajonal, ndërprerjen e migrimit të banorëve të fshatrave drejtë qendrave urbane dhe motivimin e të rinjve për kthimin në fshatra që do të ndikonte në ripërtrirjen e popullatës fshatare dhe përmirësimin e strukturës së popullatës aktive për punë, rritjen e prodhimit klasik bujqësor dhe plasmanin e produkteve sipas principeve të ekonomisë së

<sup>7</sup> [www.rugovaexperience.org](http://www.rugovaexperience.org)

tregut, afirmimi i programeve të prodhimit organik bujqësor, ruajtja e ekosistemeve natyrore dhe mbrojtja e biodiversiteteve, si dhe plasmani i kontrolluar i frutave pyjore, bimëve shëruese aromatike, rivitalizimi i potencialeve kulturore etj

## ETIKA MJEDISORE

Për të dhënë një përgjigje mbi termin “etikë” duhet te kthehemi pas në retrospektivë që nga etimologjia e kësaj fjale e deri tek shkrimet e filozofëve apo politologëve më të hershëm që e kanë përdorur këtë term. Fjala etikë buron nga shprehja greke “ethos”, “ethikos” që nënkupton moralin, qe ka domethënien e traditës, dokeve dhe shprehive.<sup>8</sup> Etika është një tërësi normash që i bën idealet, vlera në praktikat e përditshme, ndërsa vlerat janë parime të pranuar në mënyrë kolektive që e drejtojnë gjykimin tonë, drejt asaj se çfarë është e drejtë dhe e gabuar. Një tjetër përkufizim për etikën shpreh: se etika është procesi nëpërmjet të cilit dallojmë të drejtën nga e gabuara dhe veprimet në përputhje me atë që ne e quajmë të drejtë.

Etika mund të përkufizohet edhe si një përpjekje sistematike nëpërmjet përdorimit të arsyes, që i jep kuptim eksperiencës tonë morale, individuale apo shoqërore, në mënyrë të tillë, që të përcaktojë rregullat, të cilat drejtojnë sjelljen e njeriut.

### Etika si shkencë

Çka e përbën esencën e ethosit ose moralisit, qe është lëndë trajtimi jo vetëm te grekët e vjetër dhe latinët, gjegjësisht Herakliti, Sokrati, Aristoteli dhe Epikuri, por edhe shumë më vonë Spinoza, Kanti e Fichte, si edhe mendimtarët bashkëkohorë? Në mendimin grek ethosi ka të bëjë me vendbanimin, zakonin, shprehinë, sjelljen e drejtë të njeriut, institucionin, kultin e zotërave, marrëveshjet miqësore, bashkësitë e luftërave, solemnitetet e ndryshme, etj. Në mësimet etike, ethosi është qenia e etikes dhe morales. Për dallim nga Platoni, Aristoteli ka konsideruar se ethosi nuk i është dhuruar njeriut nga natyra, por njeriu e fiton këtë nëpërmjet veprimit dhe zhvillimit të dispozitave të veta. Shumë më vonë, Hegeli është përpjekur të interpretojë kuptimin dhe domethënien e përkthimeve të fjalës ethos, dhe është bërë kritik i rreptë i mendimit moral abstrakt si dhe bashkë me mendimtarë të shumtë të filozofisë së re e ka bërë të qartë

<sup>8</sup> Paviqeviq Vuko, Bazat e Etikës, Rilindja, Prishtinë, 1981, f. 8.

realitetin historik të zakoneve dhe etikës greke. Sot ekzistojnë interpretime të ndryshme mbi përmbajtjen e mësimit helen, disa përfaqësues të këtyre interpretimeve janë të prirur të thonë se te Aristoteli parimet etike kanë më shumë karakter shoqëror se sa karakter etik.

Sipas këtij mendimi, ethosi ka kuptim objektiv dhe subjektiv, sepse e ka kuptimin e shprehisë, zakonit dhe moralitetit, ndërsa morali subjektiv e ka kuptimin e ndërgjegjes, tërësinë e qenies subjektive sikur edhe tërësinë e botës në të cilën përshtatet subjekti.<sup>9</sup> Diskutimet mbi etikën mjedisore kanë lindur që në vitin 1970. “Etika e mjedisore është një degë relativisht e re e etikës filozofike dhe shqyrton e diskuton pikëpamjet mbi gjendjen morale të krijuar nga njerëzit që jetojnë ose nuk jetojnë”.<sup>10</sup> Rreth etikes mjedisore shumë autorë kanë dhënë mendimet e tyre se si njeriu ka ndërhyrë tek natyra dhe cilat janë parimet që duhet të respektohen për të siguruar një natyrë sa më të pa cenuar, por edhe këto vlera natyrore si do t’i shërbejnë zhvillimit të ardhshëm të turizmit. Shfrytëzimet e pakufizuara për themelet natyrore të jetës, shkatërrimi i pamëshirshëm i biosferës dhe militarizimi i gjithësisë janë të gjitha jashtë normave morale.”<sup>11</sup> Taylor shpjegon pikëpamjen bio-centrike, “Njerëzit janë anëtarë të komunitetit të Tokës, në të njëjtin kuptim si dhe në kushte të njëjta me gjallesat e tjera. Specia njeri, së bashku me të gjithë speciet e tjera, janë elementë përbërës në një sistem të ndërvarësisë kështu mbijetesa e çdo gjëje të gjallë, si dhe shanset e saj për mirë apo keq, janë vendosur jo vetëm nga kushtet fizike të mjedisit, por edhe nga marrëdhëniet e saj për të jetuar me të tjera gjëra”. Pra sipas të gjitha përcaktimeve në qendër të gjithçkaje qëndron njeriu i cili me veprimtaritë e tij ka sjellë ndikime të mëdha në vlerat natyrore.

### **Vlerat e natyrës**

Pyetjet themelore të etikës mjedisore që kërkojnë përgjigje janë:

“Çfarë lloj vlere i duhet dhënë mjedisit natyror nga qeniet njerëzore? A duhet t’i vlerësojmë ato, dhe të jemi të kujdesshëm në trajtimin tonë, sepse janë të dobishme për ne apo kanë vlera të pavarura ndaj interesave të njeriut? (Benson). MekShejn (2007) beson se vlerat e brendshme janë të rëndësishme për të kuptuar pikëpamjet morale dhe etike. Vlerat qëndrojnë në thelbin e etikës mjedisore dhe të dyja

<sup>9</sup> Rasim Muminović, Ethosi dhe qenie njerëzore-kthjellimi moralo-etik, botim i Fakultetit Filozofik të Tuzllës, Tuzla 1997, f. 121

<sup>10</sup> Benson, 2000, Environmental Ethics, Routledge, London UK,

<sup>11</sup> Kung & Kuschel, 1993. A Global Ethic: The Declaration of the Parliament of the World’s Religions.

udhëheqin pikëpamjet tona mbi natyrën e mjedisin.

Ndërsa Rolston (1989) gjykon se njerëzit gjithmonë do t'i japin vlerë natyrës, sepse vlera ekziston vetëm kur një subjekt ka një objekt me interes. Natyra është marrësi i këtyre vlerave, të cilat mund të jenë të dobishme apo të brendshme, subjektive apo objektive. Ai mendon se njerëzit e perceptojnë vlerën në nivele të ndryshme të perceptimit të lidhura me botëkuptimin e tyre. Literatura sugjeron se diskutimi mbi botëkuptimin e mjedisit dhe vlerave të natyrës do të mbetet një çështje e diskutueshme, sepse pikëpamjet dhe vlerat që kanë të bëjnë me mirëqenien ekonomike dhe mbrojtjen e mjedisit do të debatohen gjithmonë.<sup>12</sup>

### **Etikat mjedisore në turizëm**

Rëndësia e etikës mjedisore në turizëm shpjegohet nga Robinson dhe Phipps,<sup>13</sup> të cilët venë shenjën e barazimit midis përvojave turistike në një udhëtim personal. Sipas tyre “Të kuptosh kulturën është si të kuptosh turizmin dhe për të kuptuar turizmin duhet të na jepet të paktën një prezantim i shkurtër i njerëzimit”.<sup>14</sup> Fennell shkruan: “Turizmi nuk mund të shpjegohet nëse ne nuk e kuptojmë njeriun, qenien njerëzore”.

Etika erdhi në vëmendjen e studiuesve të turizmit në fillim të viteve 1990, në kongresin e turizmit në Paris në vitin 1992. Në këtë konferencë është theksuar ndikimi i turizmit në vende më pak të zhvilluara dhe u bën thirrje për praktika që sjellin qëndrueshmëri. Studiuesit e turizmit, propozojnë disa praktika etike si ekoturizmi, i cili merr në konsideratë ndikimet e turizmit.

Sipas Fennell (2006), turizmi ka nevojë për një teori etike të vërtetë ndërdisiplinore për zhvendosjen e vëmendjes tek ndikimet dhe ndërlihdja e vlerave me botën natyrore.

## **CONCLUSIONS AND RECOMMENDATIONS**

In these present days, we encounter a phenomenon which is a symbol of human existence and activism. This phenomenon and symbol is morality, it is subject to particular philosophical thinking, practical

<sup>12</sup> Kung & Kuschel, 1993. *A Global Ethic: The Declaration of the Parliament of the World's Religions*.

<sup>13</sup> Robinson and Phipps, 2003, ‘Worlds Passing By: Journeys of Culture and Cultural Journeys’.

<sup>14</sup> Leopold, 1974, “*A Sand Country Almanac and Sketches Here and There*” f. 178.

philosophy, and ethics. Creators of the notion of ethos are the Helens, while the moral notions are developed by the Latins.

Regarding environmental ethics, many authors have given their thoughts on how people have intervened in nature and defined which principles are to be respected to preserve and ensure a lasting natural resources, specifically the natural values as these values will serve for future development of tourism.

The importance of environmental ethics in tourism is explained by Robinson and Phipps. According to these authors, comprehending culture is the same as understanding tourism, whereas, in understanding tourism to one should at least be given a brief presentation of the mankind. Whereas, Arnocky, Stroink and DeCicco, emphasize that people with the most tendency to protect nature were those who considered themselves as part of the nature.

Understanding a community's environmental ethics will permit that in the management of protected areas, to be involved those that are equipped with relevant skills and knowledge. This will help rising awareness to the community and which in turn will help supporting the strategies that preserve nature.

Finally, due to the large number of competing tourist destinations, countries are focusing on developing marketing plans and strategies for developing these countries. Thus, so succeed, one should seek participation and involvement of all interested parties in terms of historical and cultural dimensions, environmental protection and tourist resources, staff training and professional education, and also general management of tourist destinations.

Cultural heritage defines the identity of a human community and constitutes a precious resource which, by its complex nature, is not renewable and therefore needs to be protected and valued to guarantee longevity. In this case, the diversity of Kosovo's cultural and natural heritage presents an important factor or a fundamental prospect for a development of tourism. Although, due to missing appropriate infrastructure and promotional investments for what can be offered in terms of political and economic stability, accommodation and the proper infrastructure environment. Let us say, natural wealth and historical culture have always been privileged from observers and preservers of art and culture, since they are their true reflectors of tourist-cultural offerings. Thus, besides preserving and caring with investment in

infrastructure, a strategic plan for development of this sector as a lasting source of economic growth and employment should be developed.

1. The success of developing a competitive and sustainable tourism destination is the development of activities involving the community and the reduction of the power of local government in decision-making processes.

2. Awareness of host communities regarding the importance of their participation in building strategies, plans, and tourism development programs.

3. Increase training for local government representatives to tell about the forms, ways and techniques that should be used to ensure a broader community participation in local development processes.

4. Increased cooperation between local and regional operators.

5. Realization of successful cooperation between local government, communities and private operators in building, realization of strategies, plans and programs for tourism development.

6. Cross-country territorial plans, tourist planning and local and national marketing plans.

7. Quantitative multiplication and qualitative improvement of tourism products creating a logo for each rural tourist destination.

9. To create entertainment facilities not only for tourists but also for the host community.

10. Rebuild the artisan work centers.

11. Increase investment in infrastructure in tourist areas.

12. Maintain and invest in natural, cultural and archaeological monuments.

13. Promote interested areas.

14. Provide opportunities for investors to receive low interest loans.

15. Eliminate the effect of deforestation and regenerate forests.

## LITERATURA

1. [http://www.kohajone.com/html/artikull\\_56926.html](http://www.kohajone.com/html/artikull_56926.html)
2. Krasniqi Mr. Armand, "E drejta në turizëm dhe hotelieri", Pejë 2004, fq 23
3. [http://www.kryeministriks.net/repository/docs/Strategjia\\_dhe\\_Plani\\_i\\_Veprimit\\_per\\_Biodiversitet.pdf](http://www.kryeministriks.net/repository/docs/Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit_per_Biodiversitet.pdf)

4. <http://www.mti-ks.org/sq/Divizioni-i-Turizmit>
5. Konferenca “Perspektiva e Turizmit Fshatar në Regjioni n e Rugovës”, 07.Prill.2007, Pejë, f. 1-4
6. [www.rugovaexperience.org](http://www.rugovaexperience.org)
7. <http://visitkosova.org>
8. Paviqeviq Vuko, Bazat e Etikës, Rilindja, Prishtinë, 1981, fq 8
9. Rasim Muminović, Ethosi dhe qenie njerëzore-kthjellimi moralo-etik, botim i Fakultetit Filozofik të Tuzllës, Tuzla 1997, f. 121
10. Benson, 2000, *Environmental Ethics*, Routledge, London UK,
11. Kung & Kuschel, 1993. *A Global Ethic: The Declaration of the Parliament of the World’s Religions*.
12. Kung & Kuschel, 1993. *A Global Ethic: The Declaration of the Parliament of the World's Religions*.
13. Robinson and Phipps, 2003, ‘Worlds Passing By: Journeys of Culture and Cultural Journeys’,
14. Leopold, 1974, “*A Sand Country Almanac and Sketches Here and There*” f. 178
15. Norton (1991) ‘Environmental Ethics and the Rights of Future Generations’ f. 156
16. Jakupi Ali, Bazat e Marketingut, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2000,
17. Buhalis D. (2000) “Marketing the Competitive Destination of the Future”, *Tourism Management*.
18. Benson, J. 2000. *Environmental Ethics*, Routledge, London UK.
19. Eriksson, R. 2004. ‘On the ethics of environmental economics as seen from textbooks’, *Ecological Economics*, vol. 52, no. 4.
20. Fennell, D. 2006. *Tourism Ethics*, Aspects of Tourism, Channel View Publications, UK.
21. Leopold, A. 1974. *A Sand Country Almanac and Sketches Here and There*, reprint of 1949 edn, Oxford University Press, New York.